**VENDIM**
**Nr. 528, datë 6.8.2014**

# PËR TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2015-2017

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, dhe të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2015-2017, sipas lidhjes nr. 1, "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 110, datë 27.2.2014, i Këshillit të Ministrave, "Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2015-2017", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

